



REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE 2026

Nr. Ren dor	Data e kërkesës	Objekti i kërkesës	Data e përgjigjes	Përgjigje	Mënyra e përfundim it të kërkesës	Tarifa
1.	17.02.2026	1. Një kopje të raportit të numrit total të mostrave të grurit, misrit, elbit dhe thekrës të analizuara përgjatë periudhës kohore 2014-2025 për mikotoksinat AFB1, AFB2, AFG1, AFG2 dhe OTA. 2. Një kopje të raportit për përqindjen e mostrave që kanë rezultuar mbi nivelet	05.03.2026	Në përgjigje të shkresës suaj me Nr. 116/101 Prot., datë 17.02.2026, me lëndë “Kërkesë për informacion”, ju informojmë si më posht vijon: Në referim të pyetjes 1 : Për periudhën 2014-2025, kampionet e ardhura për analizimin e aflatoksinës B1 dhe OTA në mostrat e grurit, misrit, elbit dhe thekrës kanë qenë gjithsej 200, nga të cilat kanë rezultuar 185 negativ, 13 pozitiv dhe 2 vënie në dijeni (Prani*). Në referim të pyetjes 2 : Në kampionet e	E Pjesshme	0

		maksimale të lejuara për mikotoksinë n AFB1 dhe total AF, sipas legjislacionit në fuqi dhe kriterëve të kërkuara nga Bashkimi Evropian, për periudhën kohore 2014-2025. 3. Një kopje të rezultateve laboratorike për AFB1, AFB2,, AFG1, AFG2 dhe OTA për periudhën kohore 2014-2025. 4. Një kopje të raportit të masave administrati ve të ndërmarra në rastet kur janë konstatuar tejkalime të niveleve maksimale të këtyre mikotoksina ve, për periudhën		analizuara për mostrat grurë rezultojnë 91 negativ (100%), për mostrat e mistrit rezultojnë 100 total ku 87 negativ (87%), 13 pozitiv (13%) dhe 2 mostra misër vënie në dijeni, për mostrat e elbit rezultojnë 7 negativ (100%). Në referim të pyetjes 3 : Lidhur me kopjet e rezultateve laboratorike të raporteve të provës të cilat kërkohen, ato përmbajnë të dhëna personale dhe sensitive të subjekteve, dhe trajtohet me kujdes të veçantë dhe mbrohet në përputhje me ligjin nr. 9887/2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar, si dhe me nenin 17 të Ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, të ndryshuar, i cili parashikon kufizime të së drejtës për informim në rastet kur publikimi mund të çenojë privatësinë dhe të dhënat personale të individëve. Po ashtu, në zbatim të nenit 35 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 8 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, ISUV si autoritet publik ka detyrimin ligjor të mbrojë të dhënat që lidhen me jetën private dhe aktivitetin	
--	--	---	--	---	--

	kohore 2014-2025. 5. Një kopje të raportit të produkteve të bllokuara apo të asgjësuar për shkak të kontaminimit me aflatoksina ose OTA, për periudhën kohore 2014-2025. 6. Një kopje të raportit për incidencën dhe kontaminimin e AFB1, për misrin, grurin dhe elbin për periudhën kohore 2014-2025. 7. Një kopje të raportit të planeve të monitorimit për të gjitha zonat e Shqipërisë, si dhe krahasimin e kryer me vendin tonë dhe me vendet e	profesional të subjekteve. Në këtë kuadër, e drejta për informim dhe e drejta për mbrojtjen e të dhënave personale janë të drejta të ndërlidhura ngushtësisht, ku respektimi i njërës nuk mund dhe nuk duhet të cënojë garantimin e tjetrës. ISUV, si institucion publik me funksione laboratorike dhe rregullatore, është i detyruar të veprojë në përputhje me këto parime dhe dispozita ligjore për të garantuar konfidencialitetin, integritetin dhe përdorimin e drejtë të informacionit që administron. Për këto arsye, kjo e drejtë i takon vetëm klientëve të laboratorit dhe përputhet me legjislacionin përkatës. Në referim të pikave 4, 5, 6, 7, 8 dhe 10 të shkresës suaj, Ju informojmë se nuk janë në kompetencën e ISUV. Në referim të pyetjes 9 : Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë (ISUV) ka 17 laboratorë të akredituar nga Drejtoria e	
--	--	--	--

		tjera, për periudhën kohore 2014-2025. 8. Një kopje të raportit të fondit buxhetor për periudhën 2014-2025, në lidhje me analizat, kontrollet, masat administrati ve të marra. 9. Sa laboratorë keni të akredituar? 10. Sa analiza kryeni në vit rreth sigurisë ushqimore? 11. A keni zgjedhur laborator tjetër të huaj, si ai i “C. Group”, në Belgjikë?		Përgjithshme e Akreditimit (DPA). Në referim të pyetjes 11 : ISUV, për analizimin e Aflatoksinës B1, ka bashkëpunuar me laboratorë referencë të huaj, konkretisht me laboratorin CER Group, Belgjikë		
2.	02.03.2026	Në cilësinë e një qytetari të shqetësuar për shëndetin dhe mirëqenien e	03.03.2026	Në vijim të komunikimit tuaj me e-mail lidhur me zbatimin e rregulloreve për të gjithë zinxhirin e kontrollit në fushën e shëndetit dhe mirëqenies së kafshëve, dëshirojmë	E pjesshme Deleguar në institucion in kompetent	0

		kafshëve, si dhe për respektimin e standardeve veterinarë në strukturat publike, paraqes këtë ankesë formale lidhur me situatën alarmante në Streheza Veterinarë, nën administrimin e Bashkisë Tiranë. Sipas informacioneve të disponueshme publikisht, para rreth dy ditësh është raportuar prania e Parvovirusit (CPV) brenda strukturës, si dhe ngordhja e të paktën një kafshe, çka përbën një indikator serioz të një situate potenciale epidemiologjike brenda		t'ju sqarojmë se kjo çështje nuk përbën kompetencë dhe detyrë funksionale të Institutit të Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë (ISUV). Për sa më sipër, vlerësojmë se kërkesa në fjalë duhet t'i drejtohet Autoritetit Kombëtar të Veterinarisë dhe Shëndetit të Bimëve (AKVSHB), si institucioni përgjegjës për zbatimin dhe mbikëqyrjen e kuadrit rregullator në këtë fushë. @Info AKVMB Ju lutem bazuar në nenin 12, pika 2 të Ligjit Nr.119/2014 vënjen në dispozicion të informacionit të kërkuar.		
--	--	--	--	--	--	--

		një ambienti kolektiv me rrezik të lartë për përhapje. Duke marrë në konsideratë natyrën jashtëzakonisht rezistente dhe shumë ngjitëse të Parvovirusit në mjedis, ekzistojnë dyshime të arsyeshme për: • Dëshim në zbatimin e protokolleve të karantinës • Mungesë ose pamjaftueshmëri të dezinfektimit të ambienteve • Moshë të rasteve të dyshuara ose të konfirmuara • Mbrojtje të strukturës dhe rrezik të përhapjes masive të				
--	--	---	--	--	--	--

		infeksionit • Rrezi kim të drejtpërdrejt ë të mirëqenies së kafshëve nën kujdes institucional Theksoj se, sipas kuadrit ligjor në fuqi: • Ligji nr. 10465/2011 “Për Shërbimin Veterinar në Republikën e Shqipërisë” • Ligji nr. 10237/2010 “Për Sigurinë Ushqimore” • Si dhe aktet nënligjore për bio-sigurinë dhe kontrollin e sëmundjeve infektive të kafshët autoritetet veterinare dhe institucionet përkatëse kanë				
--	--	--	--	--	--	--

		detyrim ligjor për monitorimin , kontrollin, parandalimin dhe menaxhimin e sëmundjeve infektive në strukturat që mbajnë kafshë në mënyrë kolektive, veçanërisht kur këto janë struktura publike. Mosndërhyrja në kohë në një situatë me dyshime për shpërthim infektiv mund të përbëjë: • Shkelje të standardeve sanitare veterinarë • Neglizhencë institucionale në kontrollin e sëmundjeve • Rrezikim të shëndetit të kafshëve dhe përhapje				
--	--	---	--	--	--	--

		të pakontrolluar të infeksionit Për sa më sipër, kërkoj zyrtarisht: 1. Inspektim urgjent sanitar dhe veterinar në ambientet e strehezës. 2. Verifikim të protokolleve të dezinfektimit, izolimit dhe menaxhimit të sëmundjeve infektive. 3. Transparencë mbi numrin e rasteve të dyshuara/pozitive me Parvovirus dhe masat e marra. 4. Hartimin e një raporti zyrtar mbi kushtet higjieno-sanitare dhe bio-sigurinë e strukturës.				
--	--	--	--	--	--	--

		Në bazë të Ligjit nr. 10465/2011 “Për Shërbimin Veterinar”, institucionet kompetente veterinare kanë detyrim ligjor të monitorojnë, kontrollojnë dhe të ndërhyjnë në rastet e dyshuara të shpërthimeve të sëmundjeve infektive në struktura që mbajnë kafshë, veçanërisht në ambiente kolektive publike siç janë strehezat bashkiake. Në vijim, duke qenë se bëhet fjalë për një strukturë publike me rrezik epidemiologjik potencial për shkak të një sëmundjeje				
--	--	--	--	--	--	--

		infektive shumë ngjitëse, ju vë në dijeni se në rast të mungesës së marrjes së masave konkrete verifikuese, sanitare dhe institucionale brenda një afati të arsyeshëm administrativ, do të paraqitet kallëzim (denoncim) pranë organeve kompetente për “shpërdorim detyrës”, sipas nenit 248 të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë, si dhe për mosushtim të detyrimeve ligjore që burojnë nga Ligji nr. 10465/2011 “Për Shërbimin Veterinar në Republikën e Shqipërisë”				
--	--	---	--	--	--	--

		dhe Ligji nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”. Gjithashtu, në bazë të Ligjit nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”, kërkoj që kjo ankesë të regjistrohet zyrtarisht në protokollin e institucionit tuaj dhe të pajisem me numrin përkatës të protokollit, si dhe konfirmim me shkrim të marrjes së saj. Në cilësinë e një kërkesë zyrtare për informacion dhe verifikim administrativ, kërkoj transparencë mbi hapat e ndërmarrë, rezultatet e inspektimit (nëse kryhet) dhe masat e marra në zbatim të				
--	--	--	--	--	--	--

		Ligjit nr. 10465/2011 “Për Shërbimin Veterinar në Republikën e Shqipërisës” . Situata e raportuar nuk paraqet një rast të izoluar, por duket se po përsëritet në mënyrë shqetësuese, me raste të njëpasnjësh me ngordhjesh dhe dyshime për trajtim të pamjaftueshëm veterinar. Kjo krijon perceptimin e një problematik e sistematike në menaxhimin sanitar dhe epidemiologjik të strukturës, si dhe ngre pikëpyetje serioze mbi zbatimin real të protokolleve të trajtimit,				
--	--	--	--	--	--	--

		izolimit dhe dezinfektimi t. Mosreagimi i dukshëm institucional përballë situatave të përsëritura të këtij lloji cenon besimin publik dhe përforcon shqetësimin se standardet minimale të mirëqenies dhe kontrollit veterinar nuk po respektohen në mënyrë të vazhdueshme.				
3.	30.03.2026	Pershendetje si je , dua te bej analizat e tokes, dua te di sa shkon cmimi dhe sa vonohen si procedure.	31.03.2026	Përsëndetje, Në lidhje me kërkesën tuaj për kryerjen e analizave të tokës, ju informojmë se ky shërbim nuk është objekt i veprimtarisë së Institutit të Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë (ISUV). Për këtë arsye, ju sugjerojmë të drejtoheni në Qendrën e Transferimit të Teknologjive Bujqësore që ofrojnë këtë lloj shërbimi.	E Pjesshme	0

				Faleminderit për mirëkuptimin,		
4.	04.05.2026	Përshëndetje ,Po ju kontaktoj për të kërkuar kryerjen e një analize laboratorike për një mostër ushqimore me përbërje të panjohur, për të cilën kemi dyshime se mund të jetë e dëmshme/he lmuese për kafshët. Mostra është marrë në zonën e Tropojës dhe dyshohet se i është dhënë një lope në pronësi të familjes sonë. Substanca paraqitet në formë qulli dhe ka erë të rëndë. Ju lutem na informoni:	04.05.2026	Përshëndetje z. Çuti, Faleminderit për kontaktin dhe informacionin e përcjellë. Në lidhje me kërkesën tuaj, ju bëjmë me dije se Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë (ISUV) nuk ofron shërbime për analiza toksikologjike në rastet e dyshimeve për helmime, si dhe nuk kryen analiza për produkte me përbërje të panjohur apo të paetiketuara. Duke ju falënderuar për mirëkuptimin.	E pjesshme	0

		• Njëse mund ta pranoni këtë mostër për analizë • Çfarë lloj analizash rekomandoni (toksikologjike /kimi ke) • Procedurën për dorëzimin e mostrës • Kostot dhe kohën e përgjigjes Jemi të gatshëm ta sjellim mostrën pranë institucionit tuaj në				
--	--	---	--	--	--	--

		Tiranë. Faleminderit paraprakisht për bashkëpunimin.				
5.	04.05.2026	Përshëndetje, Po ju drejtohem sërish në mënyrë urgjente në lidhje me një problem serioz veterinar dhe higjieno-sanitar në zonën tonë të banimit, i cili vazhdon të përbëjë rrezik të lartë për shëndetin e kafshëve dhe banorëve. Kjo çështje është adresuar edhe më herët pranë institucionit tuaj, por vlerësimi i mëparshëm nuk ka reflektuar realitetin e situatës në terren dhe problematika vijon të	05.05.2026	Përshëndetje, Në vijim të komunikimit me e-mail dhe në referim të shqetësimit të paraqitur nga ana juaj, ju bëjmë me dije se Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë (ISUV), në cilësinë e laboratorit qendror, nuk ka në kompetencat e tij ushtrimin e aktiviteteve të inspektimit në terren, si dhe monitorimin apo zbatimin e rregullave të biosigurisë, si për çështjet veterinare ashtu edhe për ato higjieno-sanitare që lidhen me aktivitetet e fermës, proceset e therjes apo menaxhimin e mbetjeve të gjeneruara. Për ndjekjen dhe trajtimin e mëtejshëm të kësaj problematike, ju lutemi t'i drejtoheni institucioneve përgjegjëse, përkatësisht: • Autoritetit Kombëtar të Veterinarisë • Autoritetit	E plote	0

		përkeqësohet . Në stallën e improvizuar, të vendosur vetëm rreth 3 metra larg banesave, vazhdon aktiviteti me kafshë në kushte jashtë çdo standardi veterinar dhe higjieno-sanitar. Gjendja aktuale është përkeqësuar dhe kemi prova të reja që tregojnë qartë seriozitetin e situatës. Nga dokumentacioni që disponojmë (foto dhe video), konstatohet se: - Kafshët thehen në mënyrë të pakontrolluar dhe jashtë kushteve veterinare - Ka raste të ngordhjes së kafshëve në ambient - Mbetjet		Kombëtar të Ushqimit Duke ju falënderuar për mirëkuptimin. Me respekt,		
--	--	---	--	--	--	--

		organike hidhen në mjedis të hapur, duke krijuar ndotje të vazhdueshme - Zona është kthyer në burim insektesh, parazitësh dhe erërash të rënda - Ekziston rrezik i drejtpërdrejt ë për përhapje sëmundjesh infektive Rasti është bërë tashmë edhe më i njohur në komunitet dhe ka marrë vëmendje mediatike, duke e bërë edhe më urgjente nevojën për një vlerësim të saktë dhe ndërhyrje efektive. Në këtë kontekst, kërkojmë: - Rishqyrtim urgjent dhe inspektim të plotë në teren				
--	--	---	--	--	--	--

		- Vlerësim real të kushteve aktuale, bazuar në situatën e përkeqësuar - Marrjen e masave për eliminimin e vatrës së infeksionit - Koordinim me institucionet përkatëse për ndalimin e aktivitetit problematik Bashkëngjitur do të dërgojmë prova të reja fotografike dhe video që dokumentojnë gjendjen aktuale. Në pritje të ndërhyrjes suaj urgjente dhe këtij rasti të trajtuar me seriozitetin që kërkon situata.				
6.	20.05.2026	Kam blerë fidanë domateje me nënshartesë rezistente ndaj fusariozës, për të cilët kam paguar	21.05.2026	Në lidhje me kërkesën tuaj për kryerjen e analizave laboratorike dhe vlerësimin teknik të fidanëve të domates me nënshartesë rezistente ndaj fusariozës, ju informojmë se	Epjesshme	0

		me çmim më të lartë për shkak të cilësisë dhe rezistencës së pretenduar. Pas mbjelljes, bimët kanë shfaqur simptoma të forta të fusariozës, gjë që ngre dyshime mbi cilësinë e nënshartesës ose mbi kryerjen e saktë të shartimit. Dëshiroj të kryej: - analizë laboratorike për identifikimin e Fusarium spp., - verifikim fitosanitar të materialit bimor, - dhe, nëse është e mundur, vlerësim teknik mbi cilësinë e nënshartesës /shartimit. Ju lutem më		shërbimet e kërkuara nuk përfshihen në detyrat funksionale të ISUV. Për vlerësimin e cilësisë së nënshartesës, procesit të shartimit, si dhe për këshillim teknik agronomik, ju lutemi t'i drejtoheni specialistëve pranë AKVMB. @Info AKVMB @Info AKVMB Ju lutem bazuar në nenin 12, pika 2 të Ligjit Nr.119/2014 vënjen në dispozicion të informacionit të kërkuar.		
--	--	--	--	--	--	--

		informoni: - çfarë mostrash duhet të paraqes, - ku dorëzohen, - sa është kostoja e analizës, - dhe sa kohë kërkon procedura Faleminderit !				
7.	01.06.2026	Sa laboratorë funksional ë ka aktualisht ISUV dhe sa prej tyre janë të akredituar sipas standardeve ndërkombëtare? Cilat janë analizat që ISUV aktualisht nuk mund t'i kryejë në Shqipëri dhe për këtë arsye dërgohen	10.06.2026	1. Sa laboratorë funksionalë ka aktualisht ISUV dhe sa prej tyre janë të akredituar sipas standardeve ndërkombëtare? ISUV funksionon si institucion reference në nivel kombëtar dhe organizimi i tij laboratorik bazohet në kërkesat e standardit ISO/IEC 17025:2017 për laboratorët e provës. Aktualisht, në kuadër të këtij organizimi funksionojnë 38 laboratorë. Në lidhje me akreditimin, vlen të theksohet se akreditimi nuk lidhet me laboratorin si njësi organizative në tërësi,	E plote	0

		jashtë vendit? Për periudhën 2022–2024 janë shpenzuar rreth 1.88 milionë euro për analiza në laboratorë jashtë vendit. Përse nuk janë ndërtuar kapacitete të brendshme për këto analiza dhe cilat janë kostot vjetore aktuale të këtij shërbimi? A ka pasur raste kur mungesa e pajisjeve, kiteve apo akreditimit ka ndikuar në vonimin ose pamundësi në e	por me metoda dhe shërbime laboratorike specifike, të cilat vlerësohen dhe akreditoen në përputhje me kërkesat e standardeve kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe me fushën përkatëse të akreditimit të miratuar. 2. Cilat janë analizat që ISUV aktualisht nuk mund t'i kryejë në Shqipëri dhe për këtë arsye dërgohen jashtë vendit? Në raste të caktuara, ISUV përdor mekanizma nënkontraktimi për analiza specifike laboratorike. Kjo lidhet kryesisht me shërbime për të cilat kërkesa ose frekuenca e realizimit gjatë vitit nuk e justifikon investimin dhe kostot e konsiderueshme që kërkojnë për ngritjen dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës së nevojshme laboratorike. Gjithashtu, një pjesë e analizave lidhen me kërkesa të reja që burojnë nga përditësimet e vazhdueshme të legjislacionit dhe rregulloreve të Bashkimit European. Deri në	
--	--	---	--	--

		analizimit të mostrave ushqimore ? Sipas raportimeve e publike, disa departamente kyçe si mikrobiologjia dhe monitorimi i mbetjeve kanë përqindje minimale testesh të akredituara . Si ndikon kjo në sigurinë ushqimore dhe besueshmërinë e analizave? Si monitorohen aktualisht pesticidet, mbetjet kimike dhe toksinat në ushqime, dhe sa mostra kanë rezultuar		përmbushjen e plotë të këtyre kërkesave dhe rekomandimeve teknike, analiza të caktuara realizohen përmes laboratorëve të specializuar partnerë. Në këtë kontekst, prioritet mbetet garantimi i përmbushjes së standardeve dhe benchmark-eve të Bashkimit Europian, pavarësisht vendit ku kryhet analiza. 3. Për periudhën 2022–2024 janë shpenzuar rreth 1.88 milionë euro për analiza në laboratorë jashtë vendit. Përse nuk janë ndërtuar kapacitete të brendshme për këto analiza dhe cilat janë kostot vjetore aktuale të këtij shërbimi? Lidhur me fondet e përdorura për kryerjen e analizave laboratorike të specializuara, vlen të theksohet se investimi për ngritjen dhe mirëmbajtjen e	
--	--	--	--	---	--

		jokonform e gjatë viteve 2024–2025? Listën e analizave më problematike të konstatuara në produktet ushqimore gjatë dy viteve të fundit		kapaciteteve të caktuara laboratorike duhet të vlerësohet në raport me frekuencën e përdorimit dhe kërkesat teknike përkatëse. Gjithashtu, bëjmë me dije se rreth 21% e shumës së shpenzuar gjatë periudhës së referuar është rikthyer në buxhetin e shtetit gjatë vitit 2025. 4. A ka pasur raste kur mungesa e pajisjeve, kiteve apo akreditimit ka ndikuar në vonimin ose pamundësinë e analizimit të mostrave ushqimore? Siguria ushqimore është një fushë dinamike, ku kërkesat analitike dhe parametrat që monitorohen evoluojnë vazhdimisht. Në këtë kuadër, mund të ketë situata sporadike në të cilat ISUV përballet me vështirësi të përkohshme në realizimin e analizave të caktuara brenda institucionit. Këto situata nuk janë specifike vetëm për Shqipërinë, por hasen edhe në laboratorë referencë të vendeve të Bashkimit Europian, veçanërisht në rastet kur	
--	--	--	--	--	--

				paraqiten kërkesa të reja analitike, ndryshime metodologjike apo nevoja për validimin dhe akreditimin e metodave të reja. 5. Sipas raportimeve publike, disa departamente kyçe si mikrobiologjia dhe monitorimi i mbetjeve kanë përqindje minimale testesh të akredituara. Si ndikon kjo në sigurinë ushqimore dhe besueshmërinë e analizave? Të gjitha departamentet e ISUV-së disponojnë metoda të akredituara në fushat përkatëse të aktivitetit të tyre. Procesi i akreditimit zhvillohet në mënyrë graduale dhe mbështetet në prioritetet kombëtare të sigurisë ushqimore, analizën e riskut dhe kërkesat e programeve kombëtare të monitorimit. Përzgjedhja e parametrave që i nënshtrohen akreditimit bazohet në rëndësinë e tyre për mbrojtjen e shëndetit publik dhe	
--	--	--	--	--	--

				garantimin e sigurisë ushqimore, duke siguruar që kapacitetet e akredituara të adresojnë fushat me ndikimin më të lartë në sistemin e kontrollit. 6. Si monitorohen aktualisht pesticidet, mbetjet kimike dhe toksinat në ushqime, dhe sa mostra kanë rezultuar jokonforme gjatë viteve 2024–2025? Monitorimi i pesticideve, mbetjeve kimike dhe toksinave realizohet në përputhje me planet kombëtare të monitorimit, programet e bazuara në analizën e riskut dhe kontrollet zyrtare të kryera nga autoritetet kompetente. ISUV ka përgjegjësi për kryerjen e analizave laboratorike dhe raportimin teknik të rezultateve pranë institucioneve përkatëse, konkretisht AKU dhe AKVMB. Administrimi, interpretimi dhe publikimi i të dhënave mbi konformitetin ose jokonformitetin e		
--	--	--	--	--	--	--

				mostrave janë pjesë e kompetencave të autoriteteve që porosisin dhe menaxhojnë këto programe monitorimi. 7. Listën e analizave më problematike të konstatuara në produktet ushqimore gjatë dy viteve të fundit. Identifikimi dhe klasifikimi i analizave apo problematikave me risk më të lartë në produktet ushqimore kërkon një proces të plotë vlerësimi risku dhe analizë të të dhënave në nivel kombëtar. Në këtë kuadër, roli i ISUV-së mbetet i fokusuar në kryerjen e analizave laboratorike dhe raportimin teknik të rezultateve, ndërsa vlerësimi i riskut dhe përcaktimi i problematikave prioritare janë kompetenca që ushtrohen nga institucionet përgjegjëse për menaxhimin e sigurisë ushqimore.		
8.	13.08.2026	Përsëndet je,	14.08.2026	Përsëndetje, Ashtu siç edhe Ju vetë e citoni, qumështi i papasterizuar nuk duhet të konsumohet	E pjesshme	0

		Jam prind i një fëmije 4-vjeçar, i cili dje në darkë ka konsumuar pa dashje një sasi të vogël qumështi lope të papasterizuar. Për këtë arsye, doja të dija nëse mund të kryhen analiza mikrobiologjike të kampionit të qumështit që disponoj ende. Konkretisht, do të doja të kontrollohej për: - Salmonella spp.		pa iu nënshtruar më parë procesit të zierjes/vlimit në temperaturë mbi 70°C, në mënyrë që të garantohej siguria e tij për konsum. Sa i përket pretendimit Tuaj lidhur me kryerjen e analizave, për informacionin dhe verifikimin përkatës Ju lutemi t'i drejtoheni Autoritetit Kombëtar të Ushqimit (AKU), si institucioni kompetent për këtë çështje. Faleminderit për mirëkuptimin!		
--	--	--	--	--	--	--

		- <i>Listeria monocytogenes</i> - <i>Campylobacter jejuni/coli</i> - STEC / <i>E. coli</i> që prodhon Shiga toxin, konkretisht stx1 dhe stx2 - <i>Brucella</i> spp. A i kryeni ju këto analiza në qumësht të papërpunuar? Nëse jo, ju lutem a mund të më informoni për një vend ku mund të kryej keto analiza? Ju falënderoj paraprakis				
--	--	---	--	--	--	--

		ht për ndihmën.				
--	--	--------------------	--	--	--	--

Instituti i Sigurise Ushqimore dhe Veterinarise nuk ka kërkesa për informacion për muajin Janar, Prill, Korrik 2026.